

Fillimi > -Kronikë

EMRI/ Me pistoleta, municion e thika, arrestohet siriani me kombësi shqiptare në Tiranë, sa pa policët i ‘futi’ vrapit...

10 Shtator, 2021 09:08



Madhësia e tekstit: - +

TIRANA

Një sirian me kombësi shqiptare është arrestuar në Tiranë për armëmbajtje pa leje. Policia thotë se në pranga ka rënë 24-vjeçari Wasim Hajjaz.

Ai u kap me automjetin tip “Benz” në rrugën “Fuat Toptani” teksa sapo ka parë policët tentoi të largohet me vrap, madje duke hedhur armët.

Atij iu gjetën pas kontrollit 2 armë pistoleta, njëra me silenciator, municion luftarak, 2 thika, një përforcues grushti dhe një kapele me mbishkrimin Policia.

NJOFTIMI NGA POLICIA

Tiranë/Kontrolle të shtuara në të gjitha qarkun, për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Goditet brenda javës një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje nga Komisariati i Policisë Nr. 1.

Vihen në pranga një 24-vjeçar, me precedent të mëparshëm penal, i cili gjatë ndjekjes nga Policia, hodhi sendet e kundraligjshme që posedonte me vete.

Sekuestrohen 2 armë zjarri pistoleta, njëra me silenciator, municion luftarak, 2 mjete prerëse (thika), 1 përforcues grushti dhe sende të tjera të kundraligjshme.

Nga specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Nr.1 , në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë, si rezultat i kontrolleve të shtuara për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri me vete, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative në rrugën “Fuat Toptani” kanë ndaluar për kontroll një mjet tip “Benz” me drejtues shtetasin ë. H.

Shtetasi ë. H, sapo ka parë sherbimet e Policisë, ka tentuar të largohet me vrap, duke hedhur sendet e kundraligjshme që posedonte, por është kapur dhe prangosur nga Policia.

Në vijim të veprimeve gjatë kontrollit të territorit ku u konstatua ky shtetas, kontrollit fizik dhe të automjetit, iu gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale 2 armë zjarri pistoleta, njëra me silenciator, municion luftarak, 2 mjete prerëse (thika), 1 përforcues grushti, një kapele me mbishkrimin Policia.

Në përfundim të veprimeve, nga specialistët për Hetimin e Krimit u bë arrestimi në flagrancë për veprat penale “Armëmbajtja pa leje” “Mbajtja pa leje e armëve të ftohta dhe “Mbajtja pa të drejtë e uniformës” i shtetasit ë. H., 24 vjeç, i dënuar më parë për veprat “Trafikimi i qenieve njerëzore” dhe “Drejtimit i mjetit në mënyrë të parregullt”.

Nën drejtimin e Prokurorisë, vijon puna intensive për zbardhjen e qëllimit që kishte ky shtetas që qarkullonte me armë zjarri me vete.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arme pistoleta policia pranga silenciator Wasim Hajjaz

TË NGJASHME

Vizita e Merkel në Tiranë, policia merr masa: Ja të gjitha rrugët që bllokohen nesër nga ora 09:00 deri në 13:00

13 Shtator, 2021

Video/ Çmenduri në bypassin e Fierit, radari kap makinën me shpejtësi mbi 200km/h

13 Shtator, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

SHÇBA pezullon nga detyra nënkomisarin e Policisë së Durrës, nën akuzë për shpërdorim detyre

13 Shtator, 2021

Sekuestrohen mbi 12 mijë euro në Kapshticë, po nxirreshin nga Shqipëria me furgon nga një grek me banim në Gjermani

13 Shtator, 2021

Video/ Përfshihet nga zjarri magazina e një banese të vjetër në Elbasan, tymi ‘pushton’ qendrën e qytetit

13 Shtator, 2021

Sherr mes adoleshentëve në një lokal të Tiranës, plagoset me thikë 16-vjeçari

13 Shtator, 2021

Vrasja e ish-policit Santiago Malko/ Nipi i Çipurit jep dëshminë për klanin 'Duka'. SPAK dyshime se Daut Elmazi do të vëzhgonte Ervis Martinajn

13 Shtator, 2021

Zjarr në Halil të Fushë-Krujës, digjen 20 dynym shkurre, pisha e dushk, nuk rrezikohen banesat

13 Shtator, 2021

Klodiana Lala | 13 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO



Vendimi për Berishën/ Iljazaj: Basha fiton elektorat gril Lami: Ka të njëjtin stil si ish-kryetari në drejtimin e PD

13 Shtator, 2021



"Sot u zyrtarizua ftohja PD-LSI", politologu: PS aktroi shumë mirë. Iljazaj: Berisha nuk e fiton dot luftën ndaj Bashës, tani ai ka lidërshepin absolut në parti

13 Shtator, 2021



Largimi nga seanca, Lubonja: Lulzim Basha e bëri për t'i treguar publikut se nuk ka bërë kompromis me Ramën

13 Shtator, 2021

"Bukë, kripë e zemër", ambasadorja e SHBA: Nëse një ditë rastis në vështirësi, do të vij në Shqipëri. Bota duhet të nxjerrë mësim nga ky vend i vogël

13 Shtator, 2021

Zbardhet shkresa e PD drejtuar Kuvendit: Sali Berisha nuk është anëtar i grupit parlamentar demokrat

13 Shtator, 2021

Pas pritjes me lule, Vuçiq dhe Merkel takim 'ballë për ballë' në Pallatin e Serbisë

13 Shtator, 2021